



- Pj. A. Vreshtas
- S. Del - Gjyftimesor
07.03.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE TRAJNIMEVE

Nr. 2355/prot.

Tiranë, më 06.03.2023

Lënda: Mbi kërkesën tuaj për dorëzim dokumentesh me afat ruajtje përgjithmonë (RHK)

BASHKISË MALIQ

Maliq

Në përgjigje tuajës nr. 1236, datë 27.02.2023, me të cilën kërkonti të dorëzoni dokumentet me afat ruajtje përgjithmonë (RHK), të Komunës Vreshtas, të vitit 1997-2005, ju bëjmë me dije se:

Më datë 09 mars 2023, do të paraqitet pranë institucionit tuaj, inspektori i DPA, znj. Fjoralba Vukatana për të verifikuar procesin e përpunimit të dokumenteve arkivore. Rekomandimet e lëna nga inspektori duhet të plotësohen brenda një afati, që do të përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Krahas verifikimit të procesit të përpunimit nga inspektori i DPA, punonjësi i institucionit fondkrijues i cili ka kryer këtë proces duhet të bëjë hedhjen e draftit të inventarit në sistemin elektronik të DPA-së, katalogu.arkiva.gov.al/- me username: njesia.vreshtas@arkiva.gov.al dhe password: arkiva639

Nëse ju i përfundoni korrigjimet e kërkuara, përpara këtij afati, ju lutemi lajmëroni drejtpërdrejtë në adresat dpa@arkiva.gov.al dhe fjoralba.vukatana@arkiva.gov.al. Në rast se rezulton se nuk janë korrigjuar gabimet e sipërpërmendura, në përfundim të këtij afati, inspektori merr masën administrative sipas legjislacionit në fuqi, duke kryer inspektim aty për aty. Sipas pikës c, të nenit 92, të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për Arkivat", mosdorëzimi në afat dhe sipas kërkesave të këtij ligji i dokumenteve në arkivat shtetërore, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1 deri në 5 paga mujore.

Gjithashtu, bazuar në VKM nr. 360, datë 26.04.2017, të ndryshuar, dokumentacioni që dorëzohet në arkivin e përhershëm, duhet të jetë në kutitë dhe dosjet e standardit të përhershëm, të cilat prokurohen dhe kontrollohen për cilësinë e tyre nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, përpara marrjes në dorëzim nga fondkrijuesit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido